



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:205174

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06521081

KPPP.nr. 1098/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit "MCM City Center" Sh.P.K., me numër unik identifikues 810535859 dhe seli në Prishtinë, Sheshi Nënë Terezë nr.29/8, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Besim Osmani, avokat nga Prishtina, kundër debitorit N.H.R - I.M B.I., me numër unik identifikues ... dhe seli në Prishtinë, ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi, të dy avokatë nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 352/24 të datës 25.06.2024, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Fadil Hoxha me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datën 27.11.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.H.R - I.M B.I., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 352/24 i datës 25.06.2024, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Fadil Hoxha, MBETET NË FUQI.
- II. OBLIGOHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 208.00, (dyqind e tetë euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit "MCM City Center" Sh.P.K., me datë 25.06.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 352/24 duke lejuar përmbareimin ndaj debitorit N.H.R - I.M B.I., dhe atë mbi bazën e dokumenteve të besueshme: Faturë nr. 123045 e datës 04.12.2023; Faturë nr. 124002 e datës 03.01.2024; Faturë nr. 124006 e datës 02.02.2024; Faturë nr. 124010 e datës 07.03.2024; Faturë nr. 124014 e datës 02.04.2024; Faturë nr. 124018 e datës 03.05.2024

dhe Faturë nr. 124018 e datës 03.06.2024, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t'ia paguaj kreditorit shumën prej 67,077.64 EUR (gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e shtatë euro e gjashtëdhjetë e katër cent) si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhri Përmbarimor, me arsyetimin se faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbarimor, nuk janë lëshuar sipas kushteve që kërkohen nga dispozitat ligjore ngase të njëjtat nuk përmbajnë kohën e përmbushjes së detyrimeve, të cilat janë lëshuar në kundërshtim me nenin 30 të LPP-së. Shton se faturat nuk janë të përshtatshme për përmbarim, në kundërshtim me nenin 29, par. 3 të LPP-së, ku të dhënat e debitorit janë të mangëta, nuk përmbajnë numrin e biznesit apo atë fiskal të debitorit. Tutje thekson se dokumentet e besueshme në bazën e të cilave është iniciuar procedura përmbarimore, nuk janë paraqitur në njërën nga gjuhët zyrtare të vendit. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbarimor të shfuqizohet si dhe të detyrohet kreditori që të kompensojë shpenzimet e procedurës.

Kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke e kundërshtuar prapësimin e debitorit, ku ka theksuar se debitori nuk e ka kundërshtuar faktin se mes kreditorit dhe debitorit ekziston raporti kontraktual sipas Kontratës së Qirasë se datës 19.07.2011 dhe se debitori në asnjë rast nuk e ka kontestuar borxhin ose shumën që ka borxh. Shton se në fatura është dhënë afati i përmbushjes, ku në fund të faturës thuhet se fatura duhet të paguhet brenda afatit të kontratës. Tutje thekson se faturat janë në origjinal dhe kanë të gjitha tiparet e përmbarueshmërisë në kuptim të nenit 21 dhe 29, par.3 të LPP-së dhe të njëjtat janë pranuar, nënshkruar dhe vulosur nga debitori dhe se ndërmjet tyre ekziston edhe marrëdhënie kontraktuale. Po ashtu, e ka kundërshtuar pretendimin e debitorit lidhur me gjuhën e paraqitur në fatura, duke shtuar se mbi këto fatura debitorit është liruar nga tatimi, se i njëjti ka pasur mundësinë e kundërshtimit të tyre dhe se që nga nënshkrimi i kontratës së qirasë i ka pranuar në këtë përmbajtje. Andaj, i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 123045 e datës 04.12.2023; Fatura nr. 124002 e datës 03.01.2024; Fatura nr. 124006 e datës 02.02.2024; Fatura nr. 124010 e datës 07.03.2024; Fatura nr. 124014 e datës 02.04.2024; Fatura nr. 124018 e datës 03.05.2024 dhe Fatura nr. 124018 e datës 03.06.2024 mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi ndaj debitorit, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje, Gjykata gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e biznesit e debitorit e evidentuar tek pranuesi i secilës faturë, e po ashtu të njëjtat i janë bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, dhe si të tilla paraqesin bazë për lejimin e përmbarimit pasi që janë të përshtatshme për përmbarim.

Gjykata e gjeti si të pabazuar vlerësimin e pretendimit të debitorit se faturat janë të papërshtatshme për përmbarim meqenëse nuk përmbajnë kohën e përmbushjes së detyrimit kjo për faktin se në secilën faturë objekt i këtij përmbarimi, është përcaktuar shënimi se e *“Fatura duhet të paguhet brenda afatit të kontratës”*, ndërsa në Kontratën mbi Qiranë e datës 19.07.2011 pjesë e shkresave të lëndës e lidhur ndërmjet kreditorit dhe debitorit, në nenin 3 par. 3 të saj, palët janë dakorduar që pagesa e qirasë të bëhet baza mujore, në fillim të çdo muaji e jo më larg se deti më datën 5 për muajin vijues. Andaj, debitori përveç se është njoftuar me detyrimin që derivon nga faturat objekt i këtij përmbarimi, i njëjti ka qenë në dijeni edhe për afatin e pagesës së tyre, afat ky i dakorduar mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e tjera të debitorit por që gjeti se nuk plotësohen asnjë nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës përmbarimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke i'a njohur shpenzimet përfaqësuesit të kreditorit në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumë prej EUR 208.00, konform rregullores në fuqi për tarifat e avokatëve, nr. tarifor 6, lidhur me parashtrirat për përmbarimet në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 10.000,00 € e më lartë.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1098/24, datë 27.11.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.